



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241835
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05566483

AC-I-23-0248

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

K.R.U. Ujësjetësi Rajonal Prishtina, Prishtinë.

kundër

E paditura

K.B "Shtime" (në likuidim), Shtime, të cilën e përfaqëson Agjencia Kre e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kre të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Diellza Hoxha gjyqtar, duke vendosur sipas ankesës e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4942 të datës 14 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4942 i datës 14 prill 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 25 qershor 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN020-0003 të datës 12 qershor 2014, me të cilën kërkesa e tij për kompensim të faturave të pa paguara të ujit për periudhën dhjetor 2006 deri në tetor 2013 në shumë prej 14,740.44 euro refuzohet si e pa vlefshme, në bazë të dy arsyeve ligjore. Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar konstaton se me datë 17 korrik 2009 është nënshkruar kontrata e shitjes së aksioneve të NSH-së me New Company "Shtime" Agricultural Land L.C dhe Parku Teknologjik "T" SH.P.P, dhe në bazë të nenit 6 Shtojca B e kësaj kontrate detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime që i përket periudhës tre mujore para nënshkrimit të kësaj kontrate i transferohen pronarit të ri – New Company "Shtime" e jo NSH "Shtime", andaj borxhi i kërkuar nga periudha 17 prill 2009 e deri tetor 2013 është refuzuar për shkak se i takon ky borxh blerësit të ri. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se borxhi tjetër për periudhën dhjetor 2006 e deri prill 2009 është refuzuar për shkak se në bazë të nenit 374 të LMD-së është parashkruar, pasi që paditësi nuk ka ndërmarrë veprime ligjore brenda tri viteve për ta kërkuar borxhin në gjykatën kompetente.

Në ankesë paditësi i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit duke pretenduar se janë të pa bazuara në ligj. Paditësi pretendon se AKP-ja nuk ka të drejtë që zyrtarisht të deklarohet lidhur me parashkrimin edhe kur ai ekziston, pasi që është organ që vendos për çështjen dhe me këtë bie në kundërshtim me nenin 360 par.3 të LMD-së. Tutje në ankesë paditësi pohon se në bazë të kësaj dispozite ligjore as Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk mund të thirret në rregullat e parashkrimit por mund të thirret vetëm subjekti i interesuar që është debitor në marrëdhëniet e ndryshme juridike. Tutje paditësi pohon se gabimisht është zbatuar neni 374 i LMD-së, pasi që kjo do të bjerë në kundërshtim me nenin 360.3 të LMD-së. Bashkë me ankesë ka bashkangjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, formularin e kërkesës, njoftimin e AKP-së për mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit dhe një ekstrakt nga librat e kontabilitetit.

Me datë 14 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se në bazë të nenit 374 të LMD-së të gjitha kërkesat në marrëdhënien juridike kontraktuese në mes të

personave juridik parashkruhen brenda tri viteve, i cili afat rrjedh prej kur NSH-ja nuk ka përmbushur obligimin ndaj paditësit. Paditësi e ka dorëzuar kërkesën për kompensim të faturave të pa paguara të ujit për periudhën dhjetor 2006 e deri tetor 2013 në shumë prej 14,740.44 euro, ndërsa kërkesën e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 24 tetor 2013, që një pjesë e kërkesës për periudhën dhjetor 2006 – prill 2009 veç ishte e parashkruar. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi ka dështuar të paraqesë ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore për të realizuar borxhin, pranë organeve kompetente. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se AKP-ja e ka dhënë arsyetimin e qartë dhe të drejtë se pas nënshkrimit të kontratës së privatizimit të NSH-së me 17 prill 2009, bazuar në nenin 6 Shtojca B e kontratës detyrimet për mallra dhe shërbime të cilat kanë lindur në periudhën tre muaj para nënshkrimit të kontratës transferohen si obligim që duhet ti paguajë pronari i ri New Company "Shtime" e jo NSH "Shtime".

Me datë 03 maj 2023, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-14-4942 të datës 14 prill 2023, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, ose të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se pretendimet e AKP-së në lidhje me parashkrimin e borxhit nuk janë të qëndrueshme në kuptim të dispozitave të nenit 368 të LMD-së, e cila dispozitë parasheh që parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Tutje në ankesë paditësi pohon se në bazë të ekstraktit nga libri i kontabilitetit vërtetohet se debitori ka bërë pagesa në emër të ujit të shfrytëzuar. Paditësi konsideron se Aktgjykimi i ankimuar është i pa bazuar pasi që përgjatë tërë periudhës për të cilët kërkohet borxhi, shfrytëzuesi i objektit ka qenë K.B "Shtime", përkatësisht New Company "Shtime", mirëpo pronare e objektit ka qenë e paditura IMN "K" dhe të gjitha detyrimet e pa paguara nga qiramarrësit apo shfrytëzuesit duhet ti paguajë pronari, në këtë rast IMN "K". Për paditësin nuk është e rëndësishme se si kanë qenë të rregulluara raportet në mes të IMN "K" dhe N.T.P "I K" në kuptim të përmbushjes së detyrimeve ndaj paditësit për ujë dhe shërbimet e shfrytëzuara të paditësit, mirëpo për paditësin është e rëndësishme që shfrytëzuesi i objektit nuk i ka paguar detyrimet ndaj paditësit e ato detyrime duhet ti paguajë pronari i objektit në këtë rast IMN "K". Në ankesë ka kërkuar që të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i AKP-së.

Më datë 03 korrik 2023, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të ankuesit duke i konsideruara si të pabazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm. AKP-ja pohon se argumentet e saja i ka sqaruar mjaftueshëm në mbrojtje në ankesë, andaj ato nuk do të përsëriten nga se kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kre të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 24 tetor 2013, e ka dorëzuar kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit dhe kërkon kompensimin e faturave të pa paguara të ujit për periudhën dhjetor 2006 e deri tetor 2013, ndaj NSH K.B "Shtime", në shumën prej 14,740.44 euro.

Autoriteti i Likuidimit këtë kërkesë e ka refuzuar si të pa vlefshme me arsyetimin se Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar konstaton se me datë 17 korrik 2009 është nënshkruar kontrata e shitjes së aksioneve të NSH-së me New Company "Shtime" Agricultural Land L.C dhe Parku Teknologjik "T" SH.P.P, dhe në bazë të nenit 6 Shtojca B e kësaj kontrate detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime që i përket periudhës tre mujore para nënshkrimit të kësaj kontrate i transferohen pronarit të ri – New Company "Shtime" e jo NSH "Shtime", andaj borxhi i kërkuar nga periudha 17 prill 2009 e deri tetor 2013, është refuzuar për shkak se i takon

ky borxh blerësit të ri. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se borxhi tjetër për periudhën dhjetor 2006 e deri prill 2009, është refuzuar për shkak se në bazë të nenit 374 të LMD-së, është parashkruar pasi që paditësi nuk ka ndërmarrë veprime ligjore brenda tri viteve për ta kërkuar borxhin në gjykatën kompetente.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se pjesa e kërkesës për kompensimin e faturave nga muaji dhjetor 2006 e deri prill 2009, është parashkruar në bazë të nenit 374 par.1 të LMD-së, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës nga 17 korrik 2009 e deri tetor 2013, është refuzuar pasi që kjo pjesë e borxhit në bazë të nenit 6 Shtojca B e kontratës së shitjes i takon blerësit të ri New Company "Shtime" e jo NSH "Shtime" (në likuidim).

Kolegji i Apelit e mbështet në tërësi konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të Shkalles së I-rë të DHPGJS-së, se kjo pjesë e kërkesës për kompensimin e faturave të ujit për periudhën dhjetor 2006 e deri në prill 2009 është parashkruar, marrë për bazë faktin se kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit është dorëzuar me datë 24 tetor 2013. Me të drejtë është refuzuar edhe pjesa tjetër e borxhit për periudhën nga 17 korrik 2009 kur është privatizuar NSH-ja e deri në tetor 2013, pasi që kjo pjesë e borxhit siç ka konstatuar Autoriteti i Likuidimit dhe Shkalla e I-rë i përket blerësit të aksioneve të kësaj NSH-je, andaj pa të drejtë kjo pjesë e borxhit është kërkuar ndaj NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij në procedurën ankimore ka pohuar se nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës meqë e paditura duke i bërë pagesat, e ka pranuar borxhin.

Kolegji i Apelit nuk e merr në konsideratë si të bazuar këtë pretendim ankimor pasi që në dosje nuk ka dëshmi të qarta që vërteton se e paditura e ka pranuar borxhin qoftë edhe përmes pagesës së faturave, andaj Kolegji i Apelit konsideron se nuk ka ndërprerjeje të parashkrimit sipas nenit 373 të LMD-së siç pohon paditësi.

Paditësi në ankesë pohon se shfrytëzues dhe pronar i objektit ka qenë IMN "K" dhe shfrytëzuesi i këtij objekti duhet të paguajë borxhin për periudhën e cekur. Në fakt paditësi kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit, nuk e ka dorëzuar ndaj NSH IMN "K",

por ndaj K.B "Shtime", andaj as ky pretendim nuk konsiderohet i bazuar për të pasur një rezultat tjetër nga ai që është dhënë me Aktgjykimin e ankimuar.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk mund të ndryshohet, andaj ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, me datë 12 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 12 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues
